

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dy shqiptarët vënë në "lojë" sigurinë e policisë greke, njëri u mor me armë nga spitali, tjetri nuk u kthye në ga leja! Autoritetet në kërkim të korçarit dhe Alket Rizait
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/dy-shqiptaret-vene-ne-loje-sigurine-e-policise-greke-njer-i-u-mor-me-a-i401197
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 16:47:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8c630e4d4126fcfafb7186d1a011feae7c3a540fd91d8bb21a39f3fd39e1a8ed
TEKSTI	e30c06dbf997538fdb9f624e7e8214df01ddc91723be071412c6b0549845dd72
PAMJA	c0ccb31f8da93d119b9fd22d4b78eab05ca8c3539e5549bb00b705e46ecc257a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	70d353cb7a518600c1afaf9b0fb9991ee837859363720634b9eb2807607495f9
E MËPARSHMJA	56c43a3b18558c99d7ccf5c1e6843bb38022431241d937e724685fcc7634768e
RRËNJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, në **radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/70d353cb7a518600c1afaf9b0fb9991ee837859363720634b9eb2807607495f9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Aktualitet

14 Shtator 2026, 18:27

Dy shqiptarët vënë në "lojë" sigurinë e policisë greke, njëri u mor me armë nga spitali, tjetri nuk u kthye nga leja! Autoritetet në kërkim të korçarit dhe Alket Rizait



Shkruar nga Newsbomb



Alket Rizai dhe Gentian Çipi

Dy shqiptarë kanë vënë në lëvizje autoritetet greke brenda pak ditësh, pas dy arratisjeve të bujshme që kanë ngritur në këmbë policinë fqinje. Njëri u nxor me forcë nga një spital, në një operacion të organizuar dhe të armatosur, ndërsa tjetri nuk u kthye në qeli pas përfundimit të lejes shpërblyese.

Bëhet fjalë për Gentian Çipin, 41-vjeçar nga Korça dhe Alket Rizain, një prej emrave më të njohur të botës së krimit në Greqi. Dy raste të ndryshme, por që kanë vënë në lëvizje autoritetet greke të cilët kanë ndërmarrë një sërë operacionesh kërkimi.

Rasti i parë lidhet me Gentian Çipin, i cili u arratis nga Spitali i Përgjithshëm i Serres, pasi ishte transferuar atje nga burgu i Nigritas. Sipas mediave greke, automjeti i shërbimit të jashtëm të burgjeve kishte mbërritur pranë spitalit, ndërsa në momentin e ndalimi disa persona të armatosur, të veshur me të zeza dhe që dyshohet se u paraqitën si efektivë të njesisë OPKE iu afruan eskortës.

Ata i kërcënuan punonjësit që shoqëronin të burgosurin dhe më pas morën Çipin dhe u larguan me shpejtësi.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Showbiz & Lifestyle

"Këtë, e kam jetë të dytë", gazetari Bledi Strakosha flet për sëmundjen e tij: Është vdekjeprurëse, 50% e njerëzve nuk arrijnë as të...



Showbiz & Lifestyle

Firi prek me fjalët për djalin e saj në ditën e parë të kopshtit: Se imagjinoj dot si po ecën koha

Zbulo më shumë artikuj >

Autoritetet greke aysnojnë se arratisja ishte e organizuar. Sipas të anënave të bera publike, në operacion janë përdorur dy automjete. Njëri u gjet i braktisur në një rrugë anësore të unazës së Serres, ku u sekuestruan një kallashnikov dhe fishekë, ndërsa një automjet tjetër u gjet i djegur plotësisht në zonën e Volvit, në Selanik.



Gentian Çipi

Pas arratisjes, policia greke ka vënë në lëvizje një operacion të gjerë kërkimi në Serres, Selanik dhe zonat pranë kufijve veriorë të vendit, ndërsa nuk përjashtohet mundësia që i arratisuri të jetë larguar nga Greqia.

Çipi ishte arrestuar në shtator të vitit 2025, bashkë me dy shtetas të tjerë shqiptarë, në kuadër të hetimeve për një atentat të dyshuar ndaj një 25-vjeçari në zonën e Pylaia, në Selanik. Ai akuzohej për tentativë vrasjeje, ndërsa hetimet e autoriteteve greke e lidhnin gjithashtu me dyshime për përfshirje në një organizatë kriminale të lidhur me narkotikët.

Gjatë kontrolleve të asaj kohe, policia greke kishte sekuestruar më shumë se 30 kilogramë kanabis, armë zjarri dhe municione.

Ndërkohë që vetëm pak ditë më vonë nga arratisja e 41-vjeçarit, një tjetër emër i njohur ka arritur t'u shpëtojë autoriteteve greke.

Bëhet fjalë për Alket Rizain, i cili ndodhej në burgun e Domokosit dhe kishte përfituar leje shpërblyese që prej 7 shtatorit. Sipas mediave greke, ai duhej të rikthehej në ambientet e burgimit mëngjesin e ditës së djeshme, mirëpo nuk ishte paraqitur. Si rrjedhojë autoritetet greke e shpallën atë zyrtarisht të arratisur.

Mirëpo historia e Rizait, i cili dihet për "famën e keqe" që ka në tokën greke dhe atë shqiptare, ka marrë një tjetër rrjedhë pasi dyshohet se ai mund të jetë përfshirë në një konflikt me armë zjarri. Ngjarje e cila raportohet të ketë ndodhur një ditë më parë, 13 shtator, në një beach-bar në plazhin e Anavyssos.

Sipas të dhënave paraprake, gjithçka nisi pas ndërprerjes së muzikës për shkak të orarit. Rizai dhe personat që e shoqëronin u larguan nga lokali, por më pas 48-vjeçari shqiptar u ndal pranë automjetit të tij dhe vijoi të vendoste muzikë me volun të lartë.

Pas një debati me pronarin e biznesit, dyshohet se ky sherr u përshkallëzua. Sipas asaj që dëshmitarët kanë dëshmuar në polici, Rizai nxori një armë dhe qëilloi fillimisht në ajër. Në konflikt ndërhyri një roje sigurie nga Afganistani, i cili dyshohet se qëilloi në drejtim të shqiptarit.

Nga përplasje mbetën të plagosur një 20-vjeçar grek dhe një 41-vjeçar pakistanez. Policia greke ka arrestuar pronarin 41-vjeçar të beach-barit dhe bashkëshorten e tij 39-vjeçare. Të dy akuzohen ndër të tjera për dëshmi të rreme, pengim të drejtësisë dhe armëmbajtje pa leje.





Alket Rizai

Alket Rizai nuk është një emër i panjohur për autoritetet greke. Ai është bërë i famshëm në Greqi edhe për dy arratisje spektakolare nga burgu, në vitet 2006 dhe 2009, të dyja të realizuara me helikopter. Sipas të dhënave të publikuara nga mediat greke, nga janari i vitit 2021 deri në shtator 2026, Këshilli i Burgjeve i kishte miratuar atij 16 leje daljeje. Megjithatë këtë here Rizai nuk u kthye pas lejes së fundit dhe tashmë është në kërkim të autoriteteve.

Galeria fotografike ()



Sondazh

Poll


Lexo gjithashtu



🕒 E Hënë 17:50

Magjistratët ende pa rroga, Shoqata e Prokurorëve me 5 KËRKESA për Kuvendin: Zbatoni vendimin e Kushtetueses (FAKSIMILE)





Aktualitet

Credins bank sjell Visa Infinite, kartën e parë metalike në Shqipëri!

🕒 E Hënë 17:19



Aktualitet

"Mbahje mend, do të të vras"! Kërcënimi i gazetarit Osman Stafa, Policia nis hetimet: Mesazhi u dërgua nga një adresë false

🕒 E Hënë 15:48



🕒 E Hënë 15:42


35.3 miliardë lekë pasuri nga krimi, Risen Xhaja raporton në Kuvend: Kemi 2,665 pasuri të sekuestruara dhe 516 të konfiskuara



Aktualitet

Ndërrohet stafeta në komandën e Bazës Ajrore të Farkës, Nënkolonel Ervin Buzi i kalon detyrën Bedri Kaloshit

🕒 E Hënë 15:30



Aktualitet

Ilir Meta del nga kafazi, Apeli i GJKKO-së merr vendimin

🕒 E Hënë 15:08



🕒 E Hënë 15:02

Ergys Agasi mbahet në qelitë e Bradasheshit, SPAK dhe agjentët e BKH-së bëjnë kontroll blic dhe kapin pije alkoolike e pajisje interneti



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.